



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:162904

Datë: 26.11.2020

Numri i dokumentit: 01300574

P.nr.984//20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e praktikantës Kaltrina Namani në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen penale kundër të akuzuarve Xh.A. dhe H.A. me vendbanim në rrugën “....” fshati Komuna Shtime, për shkak në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.1503/20 e datës 20 Nëntor 2020, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1503/20 të datës 20 Nëntor 2020, për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 26 Nëntor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1503/20 e datës 20 Nëntor 2020 dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

1.I pandehuri: Xh.A. i lindur me datënga i ati, e ëma, me vendbanim në rrugën “....” fshati Komuna Shtime, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

2.I pandehuri: H.A. i lindur me datënga i ati, e ëma e gjinisëme vendbanim në rrugën” fshati Komuna Shtime, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

JANË FAJTOR

SEPSE

Me datë 26.10.2020, rreth orës 07:15 në vendin e quajtur “ Afër Fushës së Gjatë”, Rajoni Ekonomiko Pyjor Mollopolc, paralelja “22” me të cilën menaxhon Komuna Shtime-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik- Njësia e Pylltarisë, të pandehurit në bashkëkryerje me qëllim të vjedhjes së trungjeve në pyll, janë takuar nga roja e pyllit duke prere pa leje me sharre motorike të cilat i kishin për ti ngarkuar në traktorin e markës “ Ferguson” me rimorkio, dhe atë 59 copë drurë të llojit ahu, shkoze dhe paj, me diametër 14-30 cm, me lartësi 10-13, me vëllim të përgjithshëm prej 4,88m³, me ç ‘rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 635,04 €.

me te cilin veprim ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41 ,46 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së, të pandehurit i,

GJYKON

1.I pandehuri Xh.A.

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro /dyqind euro/, të cilin gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë.

2.I pandehuri H.A.

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro /dyqind euro/ të cilin gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të

ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do tu llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

Obligohen të pandehurit që në mënyrë solidore në emër të kërkesës pasurore juridike, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Komuna Shtime t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 635,04 Euro /gjashtëqind e tridhjetë e pese euro e katër cent/ në afat prej 30 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse dëmi nuk kompensohet në afatin e caktuar më lartë, me propozim të palës së dëmtuar do të bëhet përmbarimi i detyruar.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro si dhe në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si: PP.II.nr.1503/20 e datës 20 Nëntor 2020, ndaj të pandehurve: Xh.A. dhe H.A., për veprën penale në bashkëkryerje vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK-ës, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor të evidentuar më numër: PP.II.nr.1503.20 e datës 20 Nëntor 2020, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të akuzuarit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjithashtu pas vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 88/2020 me numër te ditarit 46/2020 e datës 26 Tetor 2020, Procesverbali i përpiluar për vlerësimin e dëmit me numër 88/20 i datës 26 Tetor 2020, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, vlerëson se këto prova janë

bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtit ti shpallë fajtor dhe ti shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal

P.nr.984/20 i datës 26 Nëntor 2020

**Gjyqtarja,
Mimoza Shabani**

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të tij. Kundërshtimi i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:162904
Datë: 26.11.2020
Numri i dokumentit: 01300574